



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione**

P-nr.48/2019

Prishtinë, më 26 mars 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Shemsi Syla dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardian Klaiqi-UNICEF, Besmir Radoniqi-KDI dhe Emine Jakupi-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit. Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës;
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës

Kryetarja tha se sot në rend dite kemi shqyrtimin dhe votimin e amendamenteve në Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës. Këto amendamente janë nga punëtorja e mbajtur në Durrës dhe Prevallë. Materialet i kemi pasur me kohë, nëse keni ndonjë propozim prapë mund ta diskutojmë dhe më pas t'i votojmë në pako.

Veton Berisha tha se edhe pse me vonesë i kanë marrë dy rekomandime prej organizatës Idea Partnership, që ka të bëjë me mbrojtën e vajzave nga martesat e hershme është me rëndësi për të gjithë, jo vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, por martesat e hershme po

ndodhin të të gjithë, do të ishte mirë t'i kushtojmë mbrojtje kësaj kategorie. Qendra për Punë Sociale të aktivizohet dhe ka informata dhe vepron me kohë në këtë drejtim, mendoj që i parandalon martesat e hershme.

Teuta Haxhiu tha se si çështje e kemi diskutuar dhe kërkon vëmendjen për t'u trajtuar, mund të themi që ideja është e mirë, por ndoshta pika 3 e nenit 34 është më e definuar, kurse pjesa e parë e nenit 14 është diçka e përgjithshme, që ne duhet ta thjeshtësojmë, përkundrazi ndihmon në trajtimin e rasteve dhe për këtë që thuhet në tekst këto janë raste individuale, mirëpo kërkon një riformulim më të thjeshtë më të saktë. Ndoshta na duhet pak kohë, por nuk e di a mund t'i pranojmë kështu në kontekst këto dy kërkesa, dhe në tekst të punohet pak, sidomos për nenin 14 pjesa e parë.

Mexhide Mjaku-Topalli: Në qoftë se nuk e kemi një analizë të ligjit ekzistues, ne nuk mund ta marrim si të kryer dhe ta fusim në këtë projektligj. Te neni 14 mungon trajtimi në rastet specifike në mënyrë individuale për grupet e marginalizuara, është fjala për braktisjen e shkollimit, e nga ana tjetër dihet se braktisja e shkollimit rregullohet me ligjin për arsimin parauniversitar, pastaj ka rregullore nëpër komuna, ka grupe punuese ku i trajtojnë rastet e braktisjes së shkollave. Më tutje ajo tha se kodi penal i ndalon martesat e hershme, prej moshës 16 lejohen me nënshkrimin e prindit deri në moshën 18 vjeçare, mendoj që të dy rastet janë të trajtuara nga ligjet që janë ekzistuese.

Saranda Bogujevci: Nëse në kodin penal thuhet që prindi mund të nënshkruajë për martesën e hershme ky është problem shumë i madh, së pari duhet të ndryshojë jo vetëm te komunitet, por në përgjithësi dhe mendoj që duhet të kërkohet që të ndryshohet, sepse ka shumë raste ku prindërit i kanë trajtuar fëmijët keq për shkak të interesave të tyre. Pasi që është mundësia përmes komisioneve tjera të shkohet dhe të rregullohet kjo çështje të specifikohet, që të ndalohen dhe të dënohen prindërit apo kushdo që është i përfshirë në çështje të martesave të hershme, dhe të kërkohet që të hiqet ajo pjesë ku shkruhet se prindi mund të nënshkruaj për martesat e hershme nën moshën 18 vjeçare.

Ardian Klaiqi: Ligji mbron fëmijët në të gjitha format, martesat e hershme janë vetëm një kategori e mbrojtjes së fëmijëve, nuk mund të bëhen nene të veçanta për kategori të caktuara sepse do të dilte një kod me dymijë apo tremijë nene për me i specifiku të gjitha çështjet. Sa i përket martesave të hershme gjatë periudhës në vijim do të merrni kodin e civil, dhe ne si UNICEF kemi qenë të përfshirë në grup punues. Ligji për familjen në asnjë nen nuk thotë që prindi duhet të japë leje, martesat e hershme është martesë me emancipim nuk thirret martesë e hershme, martesat në parim në Kosovë është 18 vjeç, ai nen është përjashtues dhe të gjitha procedurat e vlerësimit janë në diskrecion të gjyqtarit.

Këto dy propozime si të tilla nuk e kanë vendin në Projektligj për shkak se atëherë bëjmë diskriminim ndaj pjesës tjetër të ligjit që flet në përgjithësi për mbrojtjen.

Pas diskutimeve lidhur me këtë propozim, kryetarja hodhi në votim në pako amendamentet e propozuara nga ana e Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06L-084 për mbrojtjen e fëmijës.

Kryetarja, konstatoi se komisioni në mënyrë unanime miratoi amendamentet e propozuara dhe të njëjtat i procedon për shqyrtim në komisionet e përhershme.

2. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit për ftesën që i është bërë dhe që është përsëritur disa herë për Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për temat që kemi iniciuar dhe ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Ne duhet të reagojmë si komision, mendoj që duhet të thirret edhe në interpelancë ose debat parlamentar ministri Reçica, në një situatë urgjente për çështje shumë të rëndësishme dhe delikate për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe skemat pensionale. Ajo kërkoi që t'i përsëritet ftesa edhe një herë ministrit, t'i jepet kohë një javë dhe nëse prapë ai nuk gjen kohë atëherë mblidhemi ne, si komision, dalim me një deklaratë për ministrin Reçica që është i papërgjegjshëm ndaj ftesës së komisionit dhe ndaj situatave delikate.

Saranda Bogujevci: Këtë javë dy raste janë kërkuar prej komisionit për dy çështje, njëra për çështjen e pagesës së rrymës dhe çështja tjetër për shkyçjen e orëve të rrymës, ku janë afër katërmijë familje që janë dënuar në mënyrë të paligjshme, për shkak që nuk kanë pasur procedura të rregullta për të dëshmuar se a kanë qenë duke e vjedhur rrymën apo jo, mendoj që duhet të ftohen ZRRE, KEDS-i dhe Avokati i Popullit.

Çështja tjetër, ka të bëjë me propozimin që të thirren përfaqësuesit e ICNP-së (Komisioni ndërkombëtar për Persona të Pagjetur) dhe të fillohet një bashkëpunim më i afërt.

Teuta Haxhiu: Ne duhet të mblidhemi për këtë çështje, të ftohet Avokati i Popullit, ZRRE-ja, KEDS-i, dhe është me interes sepse po flitet për 4 mijë qytetarë, janë shkelur të drejtat e tyre sepse patjetër ka qenë e nevojshme të jetë një zyrtar dhe të mos preken orët e tyre pa prezencën e familjarit.

Mendoj që si Komision t'i bëhet një vizitë shoqatës për të Drejtat e Grave në Mitrovicë.

Çështja tjetër që ajo ngriti ka të bëjë me gratë e dhunuara gjatë luftës, kam shumë ankesa dhe shumë kërkesa, nuk po mbahen seanca të rregullta. Do ta kërkoj shkarkimin e krejt komisionit, ka kërkesa që nuk janë trajtuar fare nëse ata nuk kanë kohë apo nuk kanë kushte. Ne kemi qenë në debat me qytetaret e Skenderajt dhe kemi marrë shume kritika për shkak të kësaj neglizhence.

Mirjeta Kalludra: Sa i përket çështjes së energjisë është mirë të kemi një raport nga Avokati i Popullit, pastaj të thirren në komision ZRRE dhe KEDS-i.

Mexhide Mjaku-Topalli, u është bërë shkresë partive politike që ta sjellin raportin se sa po zbatohet ligji për barazi gjinore dhe nuk kemi marrë përgjigje, si po veprojmë në si grup punues.

Çështja tjetër kemi bërë kërkesën i kemi dorëzuar nëpër institucione për burgun e Prishtinës të shndërrohet në muze, por nuk kemi marrë përgjigje, mendoj që si komision të shkojmë të ministri i Drejtësisë dhe ta marrim një përgjigje së çka ka ndër marrë ai për këtë çështje.

Kryetarja: T'i dërgohet edhe njëherë ftesa ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, zotëri Skënder Reçica.

Në mbledhjen e ardhshme të caktohet takimi me përfaqësuesit e ICNP-së.

T'i dërgohet një vërejtje Qeverisë, për neglizhencën e komisionit për verifikim dhe njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje